

VENDIM
Nr. 569, datë 29.8.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
FUSHË-KRUJË – MILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë – Milet.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për kultura bujqësore dhe dru frutorë, me një vlerë 7 698 344 (shtatë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë, për vresht dhe dru dekorativë, me një vlerë 3 512 302 (tre milionë e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 11 210 646 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekësh.

4. Shuma e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 210 646 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 2 980 000 (dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 3.9.2012.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuadojë pronarët, për të cilët është bërë shënimi “Proces saktësimi, proces saktësimi + regjistrimi dhe proces regjistrimi”, pasi të kenë përfunduar proceset e saktësimit e të regjistrimit dhe të jetë dhënë konfirmimi zyrtar nga ZRPP-ja lidhur me këtë fakt, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Laç dhe Kurbin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në bazë të vendimeve nr. 961, datë 18.9.2009, dhe nr. 64, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Laç dhe Kurbin, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha